



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2850/prot.
24

Himarë, më, 21.06.2023

Lënda: Njoftim për zhvillimin e mbledhjes së parë të këshillit të Bashkisë Himarë

Të nderuar,

Në zbatim të nenit 48 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ju njoftoj se ditën e martë, data 27.06.2023, ora 11:00, në ambientet e sallës së stadiumit “Petro Ruci”, do të zhvillohet mbledhja e parë e këshillit të Bashkisë Himarë, me këtë rend dite:

- 1. Konstituimi i këshillit bashkiak dhe zgjedhja e organeve drejtuese e përfaqësuese.**
 - 1.1 Konstituim i këshillit bashkiak**
 - Zgjedhja e komisionit të mandateve;
 - Verifikimi i mandateve dhe miratimi i mandateve të antarëve të këshillit bashkiak;
 - Betimi i këshilltarëve.
 - 1.2 Zgjedhja e kryetarit të këshillit**
 - Paraqitja dhe prezantim i shkurtër i kandidatëve;
 - Zgjedhja e komisionit të votimit, si rregull 3 anëtarë;
 - Përgatitja dhe procedurat e votimit;
 - Shpallja e rezultateve të votimit dhe zgjedhja e kryetarit të këshillit bashkiak;
 - 1.3 Zgjedhja e zëvendëskryetarit/rëve të këshillit bashkiak**
 - Miratimi me votim i numrit të zëvendëskryetarëve të këshillit bashkiak;
 - Paraqitja dhe prezantim i shkurtër i kandidatëve;
 - Përgatitja dhe procedurat e votimit;
 - Shpallja e rezultateve të votimit dhe zgjedhja e zëvendëskryetarit/rëve të këshillit bashkiak.
 - 2. Ceremonia e marrjes-dorëzimit të detyrës së kryetarit të bashkisë.**
 - Deklarimi i vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë .
 - Kryerja e betimit të kryetarit të bashkisë.
 - 3. Zgjedhja e përfaqësuesit të këshillit të bashkisë në këshillin e qarkut.**
- Ju ftojmë të jeni të pranishëm në këtë mbledhje**

SEKRETARI I KËSHILLIT
Elena MEMUSHA

